



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFIKË



PROGRAM
Drejtimi: **Gjeografi**

Lënda: GJEO MORFOLOGJI BREGDETI

<i>Pedagogu:</i>	Dr. Andri HOXHA
<i>Ngarkesa:</i>	3 ETCS (18 orë leksione dhe 18 orë seminare)
<i>Lloji i lëndës:</i>	Me zgjedhje
<i>Programi i studimit:</i>	Master i Shkencave, Gjeografi
<i>Viti/semestri:</i>	I/II

Shkurtesë:

Gjeomorfologjia bregdetare ben pjese ne disiplinat me karakter aplikativ dhe synon qe te pajise studentet me njohurite baze mbi elementet kryesore te morfologjike bregdetare dhe te dukurive e proceseve detare qe zhvillohen ne relief si: faktoret e brendshem e te jashtem, qe ndikojne ne shperndarjen gjeografike te trajtave te relievit bregdetar, origjines se formimit dhe te relievit bregdetar. Gjeomorfologjia bregdetare perfshihet ne disiplinat me karakter zbatues dhe analizon elementet kryesore te morfologjise e te proceseve bregdetare. Jane trajtuar elementet kryesore si valet, baticat e rrymat detare, nepermjet te cilave zhvillohen trajta te larmishme erozive e depozituese bregdetare. Gjithashtu paraqiten potencialet e trajtave te relievit bregdetar te vendit tone, ne funksion te zhvillimit te qendrueshem dhe te mbrojtjes se mjedisit. Cikli i leksioneve ka per qellim qe te njohe studentet me ligjesite me te pergjithshme qe kushtezojne zhvillimin e trajtave te relievit dhe modelimin e tyre nga dukurite morfodinamike ne relievin bregdetar. Gjithashtu paraqitet evolucioni i proceseve gjeomorfologjike detare aktuale dhe raportet e varesite reciproke te shoqerise humane me relievin bregdetar. Jane trajtuar me gjeresisht proceset morfogjenike te jashtme, te tilla si, rreziqet e erozionit detar. Gjithashtu lenda synon qe studentet te njohin menyren e shfrytezimit te brigjeve detare e shkaqet e degradimit te mjedisit bregdetar, si dhe te pervesojne e te aplikojne metodat e rilevimeve gjeomorfologjike ne brigjet detare. Ne konkretizimin e lendes se paraqitur dhe pervesimin sa me te mire te saj nga studentet, rol te madh kane dhe figurat, skicat dhe fotot e ndryshme.

Temat e leksioneve:

1. Evolucioni morfotektonik e morfoklimatik i zones bregdetare. Gjurmjet perkatese te tyre ne bote.
2. Faktoret qe influencojne ne dinamikën e zones bregdetare. (2.1) Luhatjet e nivelit te detit qe pasqyrohen gjate periudhave te gjata kohore dhe per periudhat e shkurtra historike e aktuale.

(2.2) Agjentet dhe proceset e evolucionit të zonës litorale. (2.2.1) Valezimi, rrymat bregdetare, baticat e zbaticat, rrymat baticore. (2.2.2) Era, shkarkimi i ujerave lumore në det, ujerat e infiltrimit, akujt etj. (2.2.3) Proceset e tjetërsimit kimik e fizik. (2.2.4) Tjetërsimi biologjik. (2.2.5) Pjerresia dhe konfiguracioni i platformes detare. (2.2.6) Karakteristikat e brigjeve detare

3. Trajtat morfologjike të zonës bregdetare. Plazhet. Materialet e ngurta në sektorin e plazhit, tipet e plazhit, elementet morfologjike të plazhit, origjina e materialeve dhe buxheti i plazheve, luhatjet stinore të plazheve, problemet e erozionit të plazheve. Dinamika e zhvillimit të erozionit dhe të depozitimit në brigjet në plazhe. Ndikimi human dhe erozioni i plazheve. Mbrojtja e plazheve. Furnizimi artificial i plazheve. Përshatja e shoqërisë humane në raport me erozionin e plazheve. Shembuj nga autori A. Mersec. Mbrojtja e zonës litorale në brigjet e Detit të Zi, në sektorin e Soçi e Batumi. Autori-E. Binei: Menaxhimi artificial i plazheve. Autori: Radulsen: Mbrojtja nga erozioni i brigjeve detare, nëpërmjet teknologjive aktuale.

(4) Dunat litorale. Formacionet e dunave litorale. Tipet e dunave bregdetare. Raporti shoqëri humane – duna. Shembull nga autori A. Mersec: Mbrojtja e shoqërisë humane e mjedisit bregdetar.

5. Lagunat. Tipet e lagunave, faktorët që influencojnë në evolucionin morfologjik të lagunave. Vecoritë e ujerave në laguna. Elementet morfologjike të lagunave. Evolucionin morfologjik i lagunave. Karakteristikat zonale të lagunave. Shoqëria humane dhe evolucionin historik i lagunave deri në ditët e sotme.

6. Estuaret. Perkufizimi i termit estuar. Origjina dhe kushtet e ekzistencës së estuareve. Dinamika dhe vecoritë hidrologjike të estuareve. Dukuritë e sedimentimit në estuare. Menaxhimi dhe efektet e depozitimit në estuare.

7. Deltat. Faktorët dhe kushtet e zhvillimit të deltave dhe ndikimi i tyre në rreziqet gjeomorfologjike bregdetare. Deltat e tipit të thjeshtë dhe të tipit të përbërë. Kushtet e ekzistencës së deltave. Formacionet e deltave. Elementet morfologjike dhe klasifikimi i deltave. Administrimi dhe evolucionin historik i deltave në periudhën aktuale.

8. Falezat detare. Roli i ndërtimit litologjik dhe i tektonikës në zhvillimin morfologjik të falezave. Ndikimi i administrimit të evolucionit të falezave. Masat parandaluese kundër erozionit detar të falezave.

9. Rifet koralore. Mjedisin e zhvillimit të koraleve. Elementet përbërës morfologjike të koraleve. Tipet kryesore të rifeve koralore. Ndërtimi litologjik i rifeve koralore dhe raporti me evolucionin e kushteve klimatike. Degradimi i rifeve koralore nga veprimtaria humane.

10. Klasifikimi i brigjeve detare, sipas autoreve D. Xhonsen, F.P. Sipavalet, K. Cotton, Valentin, Paskoff, etj.

(11) Shoqëria e shoqërisë humane me hapësirën bregdetare. Popullimi dhe kushtet ekonomike sociale në zonën bregdetare. Problemet e ndotjes së brigjeve detare dhe format e menaxhimit të bregdetit. Poret detare dhe mjedisi human. Zhvillimi i botes organike detare dhe i degës së peshkimit. Turizmi dhe bregdeti. Zona litorale dhe urbanizimi. Shembuj nga përvojat e shteteve të ndryshme të botes dhe në Shqipëri. Kërkimet gjeomorfologjike në planifikimin dhe në rregullimin e hapësirës bregdetare.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- *Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve*

- *Angazhimi në seminare:*

10% e notës

- *Testi I: në javën e 6-të*

10% e notës

- *Testi II: në javën e 10-të*

10% e notës

- Detyra e kursit ose ese: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura bazë:

1. Accordi.B. Palmieri E. L. "Il globe terrestre e la sua evoluzione", Bologna 1986.
2. Aliaj.Sh. Melo.V. Disa tipare të evolucionit morfotektonik të relievit të vendit tonë. Studime gjeografike. Nr.2.1987. Tiranë.
3. Clifford. Em. Geomorfology of Europe, New York, 1984.
4. Derruau.M "Lex formes du relief terrestre". Paris 1979.
5. Dumas.B. Le Levant espagnol. La genese du relief, Paris, 1977.
6. Inman, D.L. and Nordstrom, C.E. (1971) On the tectonic and morphologic classification of coasts. Journal of Geology, 79: 1–21.
7. Kristo.V. Gjeomorfologjia (udhezues per pune praktike dhe detyra) Tirane, 1987.
8. Kristo.V. Gjeomorfologjia e pergjithshme. Vol.2 Tirane 1994.
9. Castiglioni.G.B. Geomorfologia. Seconda edizione. 1992. Torino.
10. Charlton.R.O. Fundamentals of fluvial geomorphology. New York 2008.
11. Fairbridge R. The encyclopedia of geomorphology. New York 1969..
12. Geco.P. Elemente te Gjeomorfologjise. Pershtatur nga Pandi Geco. Tirane 1974.
13. Panizza.M. Geomorfologia. Bologna 1992.
14. Panizza.M Geomorfologia applicata Bologna 1988.
15. Paskoff, R. (1994) Les Littoraux. Impact des Am´enagements sur leur Evolution ´ (2nd edition). Masson, Paris.
16. Sparks. Geomorphology, London 1975.

MIRATOI

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. dr. Romeo HANXHARI

Tiranë, 2017